



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë, 31.01.2014

Nr. 0204-137

**PËR: Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës së Prishtinës**  
**Halim Halimi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës**

**LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË**  
**KOMUNËS SË PRISHTINËS Nr.020-17320, pranuar me datën 29.01.2014**

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Nr.20-17320 të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës me datën 22.01.2014, **KONFIRMON** ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik:

- Vendimi Nr.20-17320 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Me respekt,

Slobodan Petrović,  
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së

**Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së**  
*Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së*  
*Arkivit të MAPL-së*



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datum, 31.01.2014  
br. 0204-137

**Za: Shpend Ahmeti, Gradonačelnik opštine Priština**  
**Halim Halimi, Predsedavajući Skupštine opštine Priština**

**Predmet: Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Priština**  
**br. 020-17320, primljeno dana 29.01.2014**

Poštovani ,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, u skladu sa njenim mandatom definisano zakonom br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi , kao i uredbe br. 02/2011, o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i Ministarstva ,dodatak XII, nakon razmatranja odluke br. 20-17320 odobreno od strane Skupštine opštine Priština dana 22.01.2014, Potvrđuje zakonitost akta i procenjuje da isti taj je u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi.

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je kao što sledi:

- Odluka br. 20-17320 o osnivanju odbora za politiku i finansije Skupštine opštine Priština.

Sa poštovanjem,

**Slobodan Petrović,**  
**Zamenik premijera i Ministar MALS-a**

**Kopija: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a**  
**Rukovodiocima odeljenja MALS-a**  
**Arhivi MALS-a**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 41, paragrafi 41.1 të Ligjit nr. 03/L - 40, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të neneve 34, paragrafi 34.1, shkronja d, dhe të nenit 44, paragrafi 44.1, shkronja a e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, dt. 25.2.2010, të dispozitave të nenit 3 të Rregullores për përbërjen dhe kompetencat e komiteteve, 01. nr. 110 - 1200, të dt. 16.6.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 22.1.2014, merr këtë

V E N D I M  
P Ë R  
FORMIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

I. Miratohet Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, si komitet i Përhershëm.

II. Formimi i Komitetit për Politikë dhe Financa, si në pikën I të këtij vendimi, ka këtë përbërje:

1. Halim Halimi, LDK, kryesues,
2. Sami Hamiti, LDK, anëtar,
3. Hazir Borovci, LDK, anëtar,
4. Yll Hoxha, Lëvizja Vetëvendosje, anëtar,
5. Hatixhe Hoxha, Lëvizja Vetëvendosje, anëtare,
- 6.....PDK, anëtar, (prezantohet më vonë),
7. Islam Pacolli, AKR, anëtar,
8. Imer Rusinovci, AAK, anëtar,
9. Cuneyd Ustaibo, KDTP, anëtar.

III. Komiteti si në pikën I të këtij vendimi, është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditim të brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, si dhe për marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

IV. Ky vendim hyn në fuqi pas dhënies së pëlqimit nga MAPL-ja, se vendimi për formimin e KPF-së është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për vetëqeverisjen lokale dhe të Rregullores së Komunës së Prishtinës nr. 110 - 392, të dt. 25.2.2010, për përbërjen dhe kompetencat e komiteteve.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS  
01. nr. 020- 17320, më 22.1.2014



KRYESUESI I KOMITETIT  
Halim Halimi, jur. i dipl.

## Arsyetim

Me qëllim të zbatimit të dispozitave të Ligjit për vetëqeverisje lokale - pjesën e komiteteve dhe të Rregullores për përbërjen dhe kompetencat e komiteteve, në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Prishtinës është caktuar pika e rendit të ditës: Themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa. Pasi zyra ligjore informojë të pranishmit për procedurën e themelimit të Komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera joobligative, përbërjen, kompetencat dhe përgjegjësit e tyre, kryesuesi kërkojë nga grupet e përfaqësuara në Kuvend që t'i propozojnë anëtarët për Komitetin për Politikë dhe Financa duke reflektuar proporcionin e vendeve që kanë partitë politike në Kuvendin e Komunës.

Për përfaqësim në Komitetin për Politikë dhe Financa, kundër ka qenë Partia demokratike e Kosovës e cila ka kërkuar që procedura e miratimit të vendimi t'i dërgohet MAPL në vlerësim të ligjshmërisë dhe nëse Ministria gjen se vendimi për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa është bazuar në dispozitat e nenit 51 dhe 52 të Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe dispozitat e nenit 2, paragrafi 2.2 të Rregullores për përbërjen dhe kompetencat e komiteteve, 01. nr. 110 - 1200 të dt. 16.6.2010, do të caktojnë përfaqësuesin e tyre në Komitetin për Politikë dhe Financa.